

# SYLLABUS

## Fakulteti Ekonomik

<b>LËNDA:</b>	<b>MIKROEKONOMIA I</b>
<b>Niveli i kursit:</b>	Bachelor
<b>Lloji i kursit:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti I
<b>Semestri:</b>	Semestri II
<b>Kodi dhe shifra e lëndës:</b>	
<b>Koha/lokacioni</b> <b>Ligjëratat:</b> <b>Ushtrimet:</b>	
<b>Mësimdhënësit e lëndës:</b>	<b>e-mail:</b>
	1. Isa Mustafa
	2. Lumir Abdixhiku
	3. Alban Hashani
	4. Alban Zogaj
	5. Florentina Xhelili
	6. Fisnik Reqica
	7. Suna Zeqiri
	8. Teuta Purrini

### 1. Përshkrimi i lëndës

Kjo lëndë do t'i njoftojë studentët me bazat e teorisë mikroekonomike, si degë e ekonomisë. Fokusi do të jetë mbi zgjedhjet dhe vendimet të cilat i marrin individët dhe ndërmarrjet në kushte të resurseve të kufizuara. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet tregut dhe aspekteve të lidhura me të, sistemin e çmimeve, dhe alokimit (apo shpërndarjen) të resurseve. Përcaktimi i çmimit në kushte të konkurrencës së plotë dhe asaj të kufizuar është një ndër elementet qendrore të lëndës. Në fund, lënda do të koncentrohet në shpërndarjen e të ardhurave dhe efektet e sektorit publik/shtetit dhe efektet e tij në ekonomi.

---

## 2. Qëllimet e lëndës

Ky modul do t'i pajisë studentët me njohuri hyrëse mbi çështjet bazike mikroekonomike lidhur me pamjaftueshmërinë, zgjidhjen, çmimet dhe alokimin e resurseve.

---

## 3. Rezultatet e pritura

Me kompletimin e këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të:

- kuptojnë natyrën e problemeve ekonomike dhe si sistemi i tregut përdorë çmimet për të alokuar resurset (burimet);
- shpjegojnë se si bashkëveprojnë akterët e ndryshëm në procesin e prodhimit dhe konsumit dhe si ndërhyjnë qeveria për të promovuar mirëqenien ekonomike;
- vlerësojnë efektet e dështimit të tregut dhe të informatave joeficiente në marrjen e vendimeve nga firmat, individët, familjet dhe agjencionet;
- jenë në gjendje të aplikojnë analizën ekonomike në tregje të ndryshme në aspektin mikroekonomik.

Ky modul, po ashtu, duhet të zhvillojë tek studentët edhe këto shkathtësi:

- Shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve;
  - Shkathtësitë e komunikimit dhe prezantimit,
  - Shkathtësitë e punës në ekip,
  - Shkathtësitë e të shkruarit,
  - Shkathtësitë e interpretimit të numrave, tabelave dhe grafeve.
- 

## 4. Metodologjia

Në tre orë ligjërata në javë dhe dy orë ushtrime, do të shtjellohet materiali mësimor, do të organizohet diskutim grupor dhe teste të vetëvlerësimit.

Në ushtrime, krahas zgjidhjes së detyrave nga lënda mësimore, do të zhvillohen diskutime për problemet e ndryshme mikroekonomike, përfshirë edhe ato në Kosovë, dhe për mjetet e zgjidhjes së tyre.

---

## 5. Literatura

Maçellari, A., Hadëri, S., Kule, Dh. dhe Qirici, S. (1999), *Hyrje në ekonomi*

Sloman, J. (2006), *Economics*, Prentice Hall

Samuelson, P. A. and Nordhaus, W. D. (2001), *Economics*, (17<sup>th</sup> edition), McGraw-Hill

---

---

## 7. Vlerësimet

Vlerësimi 1: Pas Javës së shtatë

Vlerësimi 2: Në datën e provimit\*

\*Të gjithë studentët që kalojnë kollokviumit të parë, në provimin final do ti nënshtrohen vetëm kapitujve që nuk janë përfshirë në Kollokviumin 1. Të tjerët mund ti nënshtrohen gjithë provimit

**Provimi Final:** \_\_\_\_\_

---

## 8. Politikat akademike dhe rregulloret e mirësjelljes

Studentët janë të obliguar të përcjellin me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Ata duhet të vijnë me kohë në mësim, të mbajnë qetësinë dhe të angazhohen aktivisht në dialog në ligjërata. Gjatë kohës së mësimit duhet studentët duhet t'i shkyçin telefonat celularë.

---

## 9. Metodat e vlerësimit

Kollokviumi 1: 45%

Pjesëmarrja në Ushtrime dhe Ligjërata: 10%

Provimi Final: 45% ose 90% varësisht nga suksesi i studentit ne K1

---